



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА  
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 3 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i njohur KSHPK (në tekstin e mëtejshëm) në seancën e 72-të, të mbajtur më 29.07.2022, morri vendimin vijues:

### VENDIM

Denoncimi i regjistruar me numër 12-1203/1 të datës 17.03.2021, kundër ///, gjyqtare në /// gjykatë ///, **HIDHET POSHTË.**

KSHPK-ja konstatoi se, në përputhje me Ligjin për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, nuk ka elemente për veprim kompetent për rastin në fjalë, sepse vlerësoi se kompetent për të vepruar janë organet tjera.

Lënda me numër 12-1203/11 të datës 17.03.2021 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së, në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimarrjes.

### Arsyetim

Nga një parashtrues i njohur, më datë 17.03.2021, është dorëzuar denoncim për gjyqtarin zyrtar ///, në /// gjykatë /// dhe është formuar lënda me numër 12-1203/1 të datës 17.03.2021.

Pretendimet në denoncim i referohen dyshimeve për kryerje joprofesionale dhe të pakujdesshme të funksionit nga gjyqtari /// me rastin e dhënies së aktgjykimit të /// gjykatës /// me numër /// të vitit///. Sipas parashtruesit të denoncimit, gjyqtari në procedurën konkrete nuk i ka vlerësuar provat që i ka paraqitur si paditës dhe vendimi, sipas parashtruesit, është bazuar vetëm në deklaratën e të paditurit.

Në shtojcë të denoncimit, parashtruesi ka dorëzuar një petition të datës /// drejtuar disa institucioneve, përfshirë Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në të cilin rrethanat kanë të bëjnë me pretendimet për kryerjen joprofesionale dhe të pakujdesshme të detyrës nga ana e gjyqtarit.

Pas shqyrtimit të pretendimeve në fjalë, KSHPK-ja konstatoi se denoncimi ka të bëjë me pretendime që nuk i nënshtrohen veprimit të saj kompetent, por janë pretendime që kanë të bëjnë

me veprimin kompetent të një organi tjetër kompetent, pas së cilës ka vlerësuar se KSHPK nuk ka juridiksion për të vepruar për rastin në fjalë, ndërsa lëndën do ta dorëzojë në veprimin kompetent në Këshillin e gjzqësorë të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Duke pasur parasysh të theksuarën më sipër, KSHPK vendosi si në dispozitën e këtij vendimi.

Dorëzuar deri te:  
Parashtruesi i denoncimit

Përgatiti: A.R.M  
Miratoi: NB, anëtar i KSHPK - së

KOMISIONI SHTETËRORE  
PËR PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT  
Nënkryetar  
Nuri Bajrami

